

UDHËZIM
Nr.47, datë 26.11.2009

**PËR MËNYRËN DHE AFATET E KRYERJES SË PAGESËS SË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SUBJEKTEVE TË MIRATUARA DHE TË LICENCUARA NË FUSHËN E
LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogarinë bankare të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në një nga bankat e nivelit të dytë 0.5 për qind të xhiros vjetore, si më poshtë:

a) Për vitin 2009, brenda datës 15.12.2009 duhet të derdhen shumat e mëposhtme:

i. 2 000 000 lekë shoqëritë e licencuara për kazino dhe lotari kombëtare.

ii. 1 500 000 lekë shoqëritë që organizojnë kazino elektronike.

iii. 1 000 000 lekë shoqëritë që organizojnë baste sportive dhe baste për gara në pistë.

iv. 300 000 lekë në vit për shoqëritë që organizojnë bingo tradicionale e televizive.

b) Brenda datës 31.3.2010, pjesën tjetër të detyrimit të vitit 2009 e mbetur pa u paguar, e cila plotëson vlerën 0.5 për qind të xhiros vjetore.

c) Për vitin 2010 e në vazhdim, pagesat do të bëhen me katër këste, si më poshtë vijon:

i. Kësti i parë, brenda datës 10 prill,

ii. Kësti i dytë, brenda datës 10 korrik,

iii. Kësti i tretë brenda datës 10 tetor,

iv. Kësti i katërt, brenda datës 10 janar (i vitit pasardhës).

ç) Detyrimi i shoqërive të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit llogaritet si detyrim vjetor. Periudha e detyrimit vjetor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit në vazhdim. Nëse veprimtaria në fushën e lojërave të fatit krijohet ose pushon brenda kësaj periudhe, detyrimi i shoqërive llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

2. Pagesat e kryera më 31 mars për vitin 2009 dhe çdo 10 prill për vitin 2010 e në vijim, do të shoqërohen patjetër edhe me dorëzimin pranë NJMLF-së të një kopje të bilancit dhe të pasqyrave të tjera financiare.

3. Vlera e gjobës nga ana e kundërvajtësit duhet të derdhet 100 për qind në llogarinë bankare të NJMLF-së, dhe NJMLF-ja xhiron në llogarinë e buxhetit 80 për qind të vlerës së gjobës.

4. NJMLF-ja hap llogari likuiduese në një nga bankat e nivelit të dytë si person juridik publik, ku do të depozitohen të ardhurat nga pagesat që bëjnë shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit, sipas nenit 12 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008, të ndryshuar, si dhe të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave sipas nenit 49 të ligjit.

5. Likuiditetet e kësaj llogarie nuk do të përdoren nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit gjatë vitit 2009, por do të shërbejnë si burim financimi për vitin 2010.

6. Financimet e marra nga Buxheti i Shtetit që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 149, datë 28.9.2009 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, do t’i kthehen Buxhetit të Shtetit gjatë vitit 2010.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode